



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Date: 18. 10.2013

TË GJITHA GJYKATAVE THEMELORE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

QARKORE

Për zbatimin e Ligjit Për Amnistinë

Me hyrjën në fuqi të Ligjit për Amnistinë, Nr.04/L-209, obligohen prokuroritë, administrata e burgjeve dhe gjykatat të ndërmarrin veprime urgjente procedurale me qëllim të zbatimit të plotë të këtij ligji.

Është detyrim i administratës së institucionit të prokurorit, burgjeve dhe gjykatave që të përgatisin të gjitha lëndët që do përfshihen me amnisti, në mënyrë që institucionet e lartpërmendura të kenë mundësin e fillimit të zbatimit të këtij ligji brenda afateve të përcaktuara ligjore (neni 6 par.3) .

Si procedohen çështjet nga gjykatat ?

1. *Tek akuzat e ngritura*, kur çështja ende nuk ka përfunduar, prokurori i shtetit do tërhiqet nga ndjekja, gjykata do ta formalizojë atë me vendim për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale. Nëse vendimi i dhënë me aktgjykim të formës së prerë nuk është ekzekutuar ende, ajo do ta pushojë me aktvendim procedurën e ekzekutimit, ndërkaq kur personi i përfshirë në amnisti ndodhet në mbajtje të dënimit, gjykata do të marrë aktvendim për ndërprerjen e ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit dhe pushimin e procedurës;

2. Nëse çështja ka përfunduar në shkallë të parë por aktgjykimi ndodhet në fazën e ankesës dhe çështja nuk është dërguar ende në Gjykatën e Apelit, gjykata e shkallë së parë (trupi gjykues), konform nenit 358 par.1. pika 1.3 të KPPK, e hedh poshtë aktakuzën me aktvendim dhe e pushon procedurën penale;
3. Nëse çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit sipas mjetit juridik, gjykata e refuzon akuzën konform nenit 363 pika 1.1.3 të KPPK-s;
4. Nëse çështja ndodhet në Gjykatën Supreme sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik – kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata do ta ndryshojë aktgjykimin dhe do ta refuzojë akuzën konform nenit 363. pika 1.1.3 të KPPK;
5. Kur kemi të bëjmë me bashkim veprash penale dhe njëra prej tyre është përfshirë me amnisti, gjykata e shkallës së parë do të vendosë sipas dispozitave për rishikimin jo të drejtë të procedurës penale (neni 420 të KPPK);
6. Kur Ligji për Amnistinë shprehet se amnistohen vetëm veprat që janë konsumuar në kuadër të rezistencës (neni 411, nen 1 319 KPK dhe neni 186 i LPK) ndaj vendimeve dhe masave të ligjshme të institucioneve të Shtetit, atëherë, pavarësisht se me rastin e inicimit të procedurës penale, këto veprime në aspektin formal janë vënë ose jo në ndërlidhje me veprën penale thirrje për rezistencë, amnistohen vetëm ato vepra penale qëllimi i kryerësve të të cilave ka qenë rezistenca ndaj instalimit të pushtetit dhe zbatimit të vendimeve dhe masave në një territor të caktuar, por jo edhe veprat e tjera të ngjashme që nuk janë kryer në këto rrethana dhe për këto qëllime.

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet pikës 6 të kësaj qarkoreje, ngase ekziston informacioni se administrata e SHNK-së e Republikës së Kosovës, në të dhënat që ua ka dërguar gjykatave, ka përfshirë në listë edhe personat që janë deklaruar fajtorë për vepra të ngjashme penale që janë përfshirë në amnisti, edhe pse ato nuk janë konsumuar në tendencën për të penguar instalimin e ndonjë segmenti të pushtetit në territor të caktuar, siç është, p.sh. pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare etj.

Mirëpresim ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të domosdoshme për zbatimin e plotë dhe me kohë të këtij Ligji.

Me respekt

Dr. sc. Fejzullah Hasani,
Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Shtojcë:

Së bashku me udhëzimin, në bashkangjitje janë edhe disa forma të mundshme të dispozitivit të vendimeve gjyqësore, të cilat mund të ndihmojnë me rastin e zbatimit të Ligjit për Amnestinë.

Pasi që gjykatat e kanë për detyrim, që në afat prej 60 ditësh ta shlyejnë dënimin nga evidenca e të dënuarve, me qëllim të evitimit të marrjes në procedim nga dy herë të çështjeve të njëjta, rekomandohet që me rastin e marrjes së vendimit, atij ti shtohet edhe një pikë dhe të konstatohet se shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve .

A K T V E N D I M

1. Ndaj të pandehurit hidhet poshtë aktakuza dhe pushohet procedura penale për veprën penale të parashikuar nga neni _____, ngase vepra penale është përfshirë në amnisti .

2. Ndaj të pandehurit shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve.

1. Ndaj të pandehurit _____ pushohet procedura penale për veprën penale të parashikuar nga neni _____, ngase vepra penale është përfshirë në amnisti .

2. Ndaj të pandehurit shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve.

1. Ndaj të gjykuarit _____ pushohet procedura penale dhe njëkohësisht edhe procedura e ekzekutimit të dënimit, ngase vepra penale për të cilën i gjykuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, është përfshirë në amnisti .

2. Ndaj të pandehurit shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve.

1. Ndaj të gjykuarit ndërpritet mbajtja e mëtejme e dënimit dhe pushohet procedura penale për veprën penale të parashikuar nga neni _____ , ngase vepra penale është përfshirë në amnisti .

2. Ndaj të pandehurit, shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve.

Një formë e dispozitivit të aktgjykimit, kur kemi të bëjmë me bashkim veprash penale, kur ndonjëra prej tyre është përfshirë në amnisti .

Gjykata _____, më _____, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ndaj të gjykuarit _____ pushohet procedura penale për veprën penale të parashikuar nga neni _____, ngase vepra penale është përfshirë në amnisti .

2. Ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin aktgjykimi i plotfuqishëm P.nr.____, datë _____, me të cilën i akuzuari _____ është shpallë fajtor dhe është gjykuar me dënim unik burgim prej _____, për veprat penale _____ të KPK, ashtu që për shkak të vendimit nga pika 1 e këtij aktgjykimi, me aplikimin e nenit 420 par.1 pika 1.3 të KPPK, kjo Gjykatë, të akuzuarin,

E G J Y K O N

Me dënim (unik) burgimi në kohëzgjatje prej _____

A r s y e t i m i